



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:215804

Datë: 07.11.2023

Numri i dokumentit: 04883004

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal,** me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Maloku dhe zyrtarja ligjore Ardita Tasholli në çështjen penale ndaj të pandehurit I.D., me vendbanim në Rr. “...” në Ferizaj, për shkak të veprës penale në vazhdim Vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 paragrafi 1 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK-së), sipas Aktakuzës të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1461/2023 të datës 12.10.2023 dhe veprës penale Vjedhja nga neni 313 paragrafi 2 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1286/2023 të datës 13.10.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, i cili është mbajtur më datë 01.11.2023, në të cilin morën pjesë prokurori i shtetit Sadat Topalli dhe i pandehuri I.D., pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit I.D., më datë 01.11.2023 mori dhe publikisht shpalli, kurse më datë 07.11.2023, përpiloi këtë:

**AKTGJYKIM**

**I pandehuri:**

**I.D.**, nga i ati I., e ëma S. e gjinisë A., i lindur më datë ... në Ferizaj, me vendbanim në rrugën “...” në Ferizaj, me numër personal ..., i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, recidivist.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**-I-**

### **Sepse:**

Me datë 11,12 dhe 13 tetor 2023, rreth orës 09:30, në rrugën “ .... ” në Ferizaj, saktësisht në qendrën tregtare “...” i pandehuri në vazhdimësi me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë për vete dhe tjetrin, ja merr pasurinë të dëmtuarës “V.F.S.” në atë mënyrë që i pandehuri fillimisht kishte shkuar tek Qendra tregtare “ V.F.” hynë brenda dhe shkon saktësisht tek sektori i produkteve ushqimore dhe nga aty kishte arritur të marrë disa produkte ushqimore si proshutë, kaçkavall dhe kafe e më pas arrin të largohet nga aty, me ç’rast të dëmtuarës i shkakton dëm material në vlerë prej 146.00 Euro.

- Me këtë ka kryer veprën penale në vazhdim Vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 paragrafi 1 të KPRK-së.

### **-II-**

Më datë 27.08.2023, rreth orës 22:00, në Ferizaj, saktësisht në marketin “V.F.S.”, e cila ndodhet në rrugën e “ ... ”, i pandehuri, me qëllim të përvetësimit të pasurisë për vete në mënyrë të kundërligjshme, ia merr pasurinë e personit tjetër, në atë mënyrë që hynë brenda në market dhe nga aty merr dy paketime proshuta dhe një paketim kaçkavallit dhe i fsheh nën bluzë dhe pasi anashkalon arkën për pagesë menjëherë tenton të largohet nga aty pa i paguar me ç’rast kapet nga sigurimi i lokalit.

- Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 paragrafi 2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 17, 21, 38, 42, 43, 46 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 47, 48, 49, 69, 70, 76, 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 paragrafi 1 dhe neni 313 paragrafi 2 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 452, 455 paragrafi 1 dhe 462 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së), të pandehurin e:

### **G J Y K O N**

- I. Për veprën penale nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me gjobë në shumë prej 200 € (dy qind euro) dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet ne rast se gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk

kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht, ndërsa

- II. Për veprën penale nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me gjobë në shumë prej 100 € (një qind euro).

Gjykata në bazë të nenit 76 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.5 të KPRK-ës të pandehurit të lartcekur:

## **I SHQIPTON**

- I. DËNIM UNIK ME BURGIM DHE ME GJOBË në shumën prej 300 € (tre qind euro), të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguajë brenda afatit prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale.
- II. Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, të njëjtit në pajtim me nenin 43 paragrafi 3 të KPRK-së, dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguara, i pandehuri do të vuajë 1 (një) ditë burgim, dënimi me burgim nuk mund të tejkalojë tre (3) vjet.
- III. Pala e dëmtuar “V.F.S.” në Ferizaj për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko – civil.
- IV. Obligohet i pandehuri në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro si dhe për fondin e kompensimit të viktimave të dhunës shumën prej 20 (njëzet) euro, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

### **1.Rrjedha e çështjes**

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, më datë 12.10.2023, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1461/2023, kundër të pandehurit I.D., për shkak të veprës penale në vazhdim Vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe me datë 13.10.2023, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1286/2023, kundër të pandehurit I.D., për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 paragrafi 2 të KPRK-së.

Me datë 01.11.2023, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit Sadat Topalli, i pandehuri I.D..

Në këtë seancë para leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, gjyqtari i çështjes i ka njoftuar palët se ndaj të pandehurit I.D. në këtë gjykatë zhvillohet edhe çështja penale 2023:218001, ku edhe aty pala e dëmtuar është e njëjtë andaj ka marrë aktvendim me të cilin ka bashkuar procedurën penale në çështjet penale 2023:215805 dhe 2023:218001.

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprat penale për të cilat akuzohet dhe ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale në vazhdim Vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 paragrafi 1 të KPRK-së dhe veprën penale Vjedhja nga neni 313 paragrafi 2 të KPRK-së, andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 paragrafi 2 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësinë nga ana e të pandehurit.

## **2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë**

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezentë palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale në vazhdim Vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 paragrafi 1 të KPRK-së dhe veprën penale Vjedhja nga neni 313 paragrafi 2 të KPRK-së, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore të cilat kërkohen me nenin 242 paragrafi 2 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve të cilat ishin prezentë.

Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit dhe i njëjti nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë. Pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: Raporti fillestar i incidentit i datës 14.09.2023 dhe i datës 27.08.2023, Raporti i policit hetues i datës 02.10.2023 dhe 15.09.2023, raporti i oficerit i datës 27.08.2023 dhe 14.09.2023, Deklarata e E.I. menaxhere e “V.F.S.” në Ferizaj e dhënë në Polici më datë 14.09.2023 dhe 19.09.2023, Deklarata e A.L. roje e sigurit në “V.F.S.” në Ferizaj e dhënë në Polici më datë 27.08.2023, dhe me datë 04.09.2023, Deklarata e N.H. menaxher në “V.F.S.” në Ferizaj e dorëzuar në gjykatë më datë 13.10.2023, Deklarata e të pandehurit I.D. e dhënë në Polici më datë

28.08.2023, 13.09.2023 dhe 02.10.2023, 2 (dy) fotografi të formatit A4 si dhe shkresat e tjera që gjenden në lëndë, po ashtu me rastin e pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuzat lëndore nuk përmbajnë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike lidhur me veprat penale për të cilat i pandehuri e ka pranuar fajësinë.

### **3.Gjendja faktike e vërtetuar**

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri I.D. ka kryer veprën penale në vazhdim Vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 paragrafi 1 të KPRK-së dhe veprën penale Vjedhja nga neni 313 paragrafi 2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

### **4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit për veprën penale nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi ti shqiptohet dënim në shumë prej 200 € (dy qind euro) dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht, ndërsa për veprën penale nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi dënim me dënim me gjobë në shumë prej 100 € (një qind euro), andaj të pandehurit i është shqiptuar dënim unik me gjobë në shumën prej 300 € (tre qind euro), të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguajë brenda afatit prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-së. Gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marrë: pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, faktin se i njëjti është penduar për veprat penale që i ka kryer, ka kërkuar falje publike si dhe premtimin që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, kurse si rrethana rënduese mori shkallën e lartë të dashjes nga ana e të pandehurit si dhe faktin se i

njëjti është përsëritës (recidivist) i veprave penale dhe atë në çështjen penale 2022:246529 dhe në çështjen penale 2021:216848 e plotfuqishme me datë 24.03.2022.

Gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së e që konsistojnë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### **5. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike**

Neni 462 paragrafi 2 i KPP-së përcakton se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij program”*. Andaj, pasi që nuk kishte një vlerë të saktë të kërkesës pasurore juridike dhe një veprim i tillë do ta zvarriste procedurën penale, gjykata duke u bazuar në dispozitën e lartcekur vendosi që të dëmtuarën për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzoj në kontest të rregullt juridiko – civil.

### **6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale**

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale gjykata duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që ta detyrojë të pandehurin që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro, si dhe duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për Kompensimin e Viktimave të Krimin shumën prej 20 (njëzet) Euro.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**

**2023:215805, me datë 06.11.2023**

**Zyrtarja Ligjore,**  
Ardita Tasholli

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Dardan Maloku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Ferizaj.